

Duhet të kalojë një brez dhe paratë e Evropës...

Ka një progres në studimet albanologjike, por ka mbetur edhe shumë për t'u bërë. Edhe përkundër këtyre rezultateve deri tani nuk ekziston një fjalor i plotë etimologjik i gjuhës shqipe, ndonëse vetëm brenda një viti kanë dalë tre fjalorë të kësaj natyre

Ragip Sylaj

Victor Friedman, profesor i lingvistikës, drejtor i Departamentit të gjuhëve sllave dhe të Evropës Juglindore në Universitetin e Çikagos (SHBA), ku përveç gjuhëve të tjera ballkanike mësohet edhe gjuha shqipe. Mban mësim për shqipen, sllavishten e vjetër, për maqedonishten, për gjuhët e Kaukazit etj. Më parë mësimer e shqipes në këtë departament i ka mbajtur albanologu i shquar Erik Hemp (anëtar i jashtëm i ASHAK). Deri tash ka botuar artikuj dhe studime për gjuhën shqipe dhe raportet e saj me gjuhën e Ballkanit, ashtu si dhe studime për maqedonishten. Është bashkëpunëtor i rrugullit të revistës "Studime" të ASHAK me kontribute në të gjithë numrat që janë bomar deri tash.

Zëri: Cili është qëllimi i ardhshëm në Kosovë?

V. Friedman: Qëllimi i ardhshëm në Kosovë është të takohet me Rinë Rexhep Ismajlin, meqë nuk jemi parë që nga viti 1995. Qëllimi kryesor i vizitës apo i ardhjes supe në rajonin e Ballkanit është pjesëmarrja në një konferencë për dialog, organizuar nga Ambasada amerikane në Shkup, Forumi i intelektualëve shqiptarë në Maqedoni, si dhe nikoqirët, Ary isha bashkë me kolegjin tim Robert Grinberg, preokupim i madh i të cilit është ballkanistika. Në këtë takim që më tepër i ngjante një tryeze të rrumbullakët, tema e bisedës ishte gjuha dhe arsimiti në kuadër të fushës ballkanistike.

Pse mungon fjalori etimologjik i gjuhës shqipe?

Zëri: Cilat janë rrishtë në studimet ballkanistike?

V. Friedman: Unë kam disa



Që të pajtohen shqiptarët dhe sllavët në mes veti dhe që të jetojnë në paqe si e tërë bota e civilizuar, duhet të kalojë edhe një brez dhe duhen paratë e Evropës: Victor Friedman

studime për mënyrën habitore të gjuhës shqipe në raport me gjuhën tjetër, bie fjala, të bullgarishtes. Studiuuesi Gustav Vajgand ka shkruar që në vitin 1923 për mënyrën habitore në gjuhën bullgare. Unë kam shkruar për mënyrën habitore në një roman bullgar dhe ndryshimi është i madh ndërmjet shqipes dhe bullgarishtes. Kjo mënyrë e foljes përdoret për të shprehur veprime që lidhen me dëshminë dhe me të papirurën. Unë kam shkruar disa artikuj për polinikën e gjuhëve në Ballkan, për historinë e gjuhëve shqipe e maqedonishte dhe krahasimet e tyre, si dhe për gjuhën romë, vllhehe e greke. Kam edhe studime për fjalët turke në gjuhët e Ballkanit.

Zëri: Cilat janë, sipas jush, rezultatet më të shquara në fushën e albanologjisë?

V. Friedman: Në këtë fushë ka një progres, por ka mbetur edhe shumë për t'u bërë. Rezultate të larta të kësaj fushe i konsideroj

veprat studimore të Eqrem Çabejt, Idriz Ajetit, Shaban Demirajt, Rexhep Ismajlit etj. Edhe përkundër këtyre rezultateve, deri tani nuk ekziston një fjalor i plotë etimologjik i gjuhës shqipe, ndonëse vetëm brenda një viti kanë dalë tre fjalorë të kësaj natyre.

Zëri: Maqedoni është edhe studiues i sllavistikës, si i shihni ju raportet në mes shqiptarëve dhe sllavëve në Ballkan dhe kur mendoni se do të pajtohen këta popuj që të jetojnë në paqe si e tërë bota e civilizuar?

V. Friedman: Duhet bërë një dallim midis raporteve të tilla në Kosovë, Maqedoni dhe në Mal të Zi. Tradita e bashkëjetesës në Maqedoni (sidomos në atë jugore, siç është Struga) është mjaft e vjetër. Gjuhët e tyre (shqipja e maqedonishtja) janë të një sintakse mjaft të ngjashme. Që të pajtohen këta popuj, siç thuani ju, dhe që të jetojnë në paqe si e tërë bota e civilizuar duhet të kalojë edhe një brez dhe paratë e Evropës.

Përpigem të realizoj një projekt për gjuhët ballkanike

Zëri: Cilat janë planet tuaja në fushën e studimeve albanologjike?

V. Friedman: Tani kam një projekt për gjuhët ballkanike bashkë me Brajan Xhozef (profesor i gjuhës në Ohajo Stejt, ballkanist që di greqisht etj). Do të jetë libri i parë në anglisht për këtë problem, ndonëse ka të rullë në shumë gjuhë të tjera botërore. Në manasirin e Hilandarit ekziston një defter me 19 faqe, ku është edhe një fjalor shqip-bullgarisht, që ka të bëjë edhe me turqishten. Studiuuesi shqiptar që jeton në Bullgari, Toma Kaçorri ka bërë një artikull, por përkatësi me këtë unë do të bëj një edicion kritik, pa gabime.

Zëri: Çfarë bashkëpunimi keni me albanologjët shqiptarë dhe të tjerë?

V. Friedman: Kam bashkëpunim të mirë me studiuesit e shquar të kësaj fushe, siç janë Rexhep Ismajli, Emil Lafa (në Shqipëri), Lenard Njumavk (nga Kalifornia), që ka botuar një fjalor shqip-anglisht, Eri Kemp (anëtar i jashtëm i ASHAK), Xhener Bajron etj. Pastaj Aleksandër Ruskov, Robert Elsie, që më ka ndihmuar shumë dhe Robert Denkov, të cilët kanë botuar shkrime të Evlia Çelebiut të shek. XVII.

Artistët tanë në botë

Në Itali paraqitet arti pamor shqiptar

Në Muzeun Michetti, në Paskara të Italisë, më 23 qershor do të çelët ekspozita kolektive e titulluar "Adriatica le due sponde", në të cilën marrin pjesë artistët nga vendet e Adriatikut. Në këtë ekspozitë, ku do të paraqiten rreth 30 artistë nga Italia dhe Ballkani, nga Shqipëria dhe Kosova do të paraqiten: Lala Meridith-Vula, Sislej Xhafa, Erzen Shkolollë dhe Adriani Paçi.

Ndërkaq, më 26 qershor, në Akademinë Britanike, në Romë, çelët ekspozita grupore, në të cilën do të marrë pjesë edhe artistja kosovare, Lala Meredith - Vula.

R. S.

Sonte në teatrin „Dodona“ Shfaqet „Profesor...4“

Sonte në teatrin „Dodona“ jepet shfaqja „Profesor...4“ në regji të Faruk Begollit. Aktorinë: Avni Hoti, Vjollca Kelmendi, Vjola Merovci, Ylber Pallata, Vjosa Abazi, Shengyl Ismaili, Azem Bujupi dhe Faruk Begolli. Shfaqja fillon në orën 20.30.